

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

613-25-1654-1-2-1/C1054

Kuvendi Komunal Lipjan të cilën e përfaqëson, **Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Bekim Shabani** në njërën anë (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues; dhe

Sabri Azemi B.I., 23, Norbert Jokl, PRISHTINË, ((ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

Mirëmbajtja dhe furnizimi me paisje te ndryshme për ngrohje qendrore në intitucionet Edukativo Arsimore numër identifikues: **613-25-1654-1-2-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

Mirëmbajtja engrohje qendrore në intitucionet Edukativo Arsimoredhe duke furnizuar me paisje te ndryshme për' i bërë funksionale ngrohje qendrore në Intitucionet Edukativo Arsimore (IEA) dhe infitucionet tjera komunale.

NR.	Përshkrimi i artikullit	Njësia matëse	Sasia
A	Riparimi i KALLDAJAVE të ngrohjes		
1	Furnizimi dhe montimi me Flakës - Brener të Naftës për kalldat me lëndë djegëse të (Lëngët); kapacitet Q=150-300 kë, tip: Max- ECOFLAM ose e ngjajshme dhe me karakteristika të njejta.	Copë	1
2	Furnizimi dhe montimi me Flakës - Brener të Naftës për kalldat me lëndë djegse të (Lëngët); kapacitet Q=300-500 kë; tip: Max- ECOFLAM ose e ngjajshme dhe me karakteristika të njejta.	Copë	1
3	Furnizimi dhe montimi i spirales së transporterit të peletit me kapacitet të ndryshëm për brenera ECO- PB dhe të ngjajshëm	Copë	1

4	Furnizimi dhe montimi i gypit fleksibil të brenerave të peletit me kapacitet të ndryshëm për brenera ECO- PB dhe të ngjajshëm	Copë	1
5	Furnizimi dhe montimi i nxemshit të brenerave të peletit me kapacitet të ndryshëm për brenera ECO- PB dhe të ngjajshëm	Copë	1
6	Furnizimi dhe montimi i vatrave të djeg`jes (reshetskave) për brenerat e peletit Q=50-90 kë; tip: ECO-PB ose e ngjajshme me karakteristika të njejta.	Copë	1
7	Furnizimi dhe montimi i vatrave të djeg`jes (reshetskave) për brenerat e peletit Q=100-250 kë; tip: ECO-PB ose e ngjajshme me karakteristika të njejta.	Copë	1
8	Furnizimi dhe montimi i vatrave të djeg`jes (reshetskave) për brenerat e peletit Q=300-500 kë; tip: ECO-PB ose e ngjajshme me karakteristika të njejta.	Copë	1
9	Furnizimi dhe montimi i motorrit të transporterit të peletit për breneret me kapacitet Q=50-100 kë; te modelit 5.3 rpm, 8.0 rpm dhe 12.0 rpm ose e ngjajshme me karakteristika të njejta.	Copë	1
10	Furnizimi dhe montimi i motorrit të transporterit të peletit për breneret me kapacitet Q = 100-400 kë; tip: GMAK -MKD 80 4 -37 50 Hz - 0.37 kË ose e ngjajshme me karakteristika të njejta.	Copë	1
11	Furnizim dhe montimi i pllakës elektronike për brenerat me pelet (50 - 400) kë	Copë	1

12	Furnizimi dhe montimi i pllakës elektronike për brenerat me pelet (100 - 400) kë	Copë	1
13	Furnizimi dhe montimi me display komandues për brenerat me pelet (50 - 100) kë	Copë	1
14	Furnizimi dhe montimi me display komandues për brenerat me pelet (100 - 400) kë	Copë	1
15	Pastrimi i rezervuarit të naftës komplet me korpen dhe elementet tjera përcjellëse	Copë	1
16	Mbrojtje termike nga mbingarkesat me resetim manuel dhe automatik nga nga 3,7 deri 5,5)A për motor 850Ë dhe 590Ë / 1PH	Copë	1
17	Kontaktor për pompa trefazore	Copë	1
18	Kontaktor për pompa monofazore	Copë	1
19	Furnizimi dhe montimi i Transportuesit kërrmillor të peletit për kalldajat 100 - 250 kë, komplet me elementet përcjellëse	Copë	1
20	Furnizimi dhe montimi i Transportuesit kërrmillor të peletit për kalldajat 300 kë; komplet me elementet përcjellëse	Copë	1
21	Furnizimi dhe montimi i rezervuarit të peletit me kapacitet 500 kg pelet. Në llogari hynë të gjitha elementet deri në funksionimin e plotë të rezervuarit.	Copë	1

22	Furnizimi dhe montimi i rezervuarit të peletit me kapacitet 1000 kg pelet. Në llogari hynë të gjitha elementet deri në funksionimin e plotë të rezervuarit.	Copë	1
23	Pastrimi komplet i oxhakut nga hiri dhe katrani nga fi 200 mm deri fi 500 mm për m/gjatësi	m	1
24	Furnizimi me Qynga dhe kthesa për kalldatë e llojeve të ndryshme	Copë	1
24	Shqyrtimi i instalimit në të ftohët dhe të nxehtë	Copë	1
B	SERVISIMET, RRJETI GYPOR DHE POMPAT		
26	Servisimi i brenerit të peletit me kapacitete të ndryshme	Copë	1
27	Servisimi i kalldajave me lëndë djegese pelet; kapacitet (50 - 500) kë	Copë	1
28	Servisimi i kalldajave me lëndë djegese të ngurt (dru, thengjill); kapacitet (50 - 500) kë; sanimi i rrjedhjeve eventuale duke përfshirë salldimet e nevojshme	Copë	1
29	Servisimi i kalldajave me lëndë djegese të lëngët (naftë); kapacitet (100 - 300) kë	Copë	1
30	Servisimi i flakëdhëseve me naftë; kapacitet (30-100) kë	Copë	1
31	Servisimi i flakëdhëseve me naftë; kapacitet (100-300) kë	Copë	1
32	Servisimi i gjitha llojeve të pompave qarkulluese duke përfshirë ndrrimin e pjesëve të dëmtuara si dhe mbështjellja elektrike	Copë	1

33	Servisimi i pompës qarkulluese DN 40 - 50, mbështjellja elektrike	Copë	1
34	Servisimi i pompës qarkulluese DN 65 - 80, mbështjellja elektrike	Copë	1
35	Servisimi i pompës qarkulluese DN 100 , mbështjellja elektrike	Copë	1
36	Furnizimi dhe montimi i gypave të zi metalik pa tegel (ky pozicion përfshinë largimin e gypit të dëmtuar, vendosjen e gypit të ri, saldimin eventual, zbrazen dhe mbushjen e sistemit me lëng punues)		
37	Gyp i zi DN 15	m'	1
38	Gyp i zi DN 20	m'	1
39	Gyp i zi DN 25	m'	1
40	Gyp i zi DN 32	m'	1
41	Gyp i zi DN 40	m'	1
42	Gyp i zi DN 50	m'	1
43	Gyp i zi DN 65	m'	1
44	Gyp i zi DN 80	m'	1
45	Furnizimi dhe montimi i elementeve si brryla , unaza etj nga poz. i gypave të zi (copë / metër)	Copë	1
46	Furnizimi dhe montimi i gypave Cu pa tegel (ky pozicion përfshinë largimin e gypit të dëmtuar dhe vendosjen e gypit të ri , saldimin eventual, zbrazen dhe mbushjen e sistemit me lëng punues)		
47	Gyp Cu Ø 15	m'	1
48	Gyp Cu Ø 18	m'	1
49	Gyp Cu Ø 22	m'	1
50	Gyp Cu Ø 28	m'	1
51	Gyp Cu Ø 35	m'	1

52	Furnizimi dhe montimi elementeve si berryla ,T, unaza etj nga poz. i gypave Cu (copë / metër)	Copë	1
53	Prerja e mureve dhe betonit për sanim të rrjedhjes ose për futjen e kalldasë në kalldatore	Copë	1
54	Salldimi i gypave të Çelikut DN 15 (llogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1
55	Salldimi i gypave të Çelikut DN 20 (llogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1
56	Salldimi i gypave të Çelikut DN 25 (llogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1
57	Salldimi i gypave të Çelikut DN 32 (llogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1
58	Salldimi i gypave të Çelikut DN 40 (llogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1
59	Salldimi i gypave të Çelikut DN 50 (llogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1
60	Salldimi i gypave të Çelikut DN 65 (llogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1
61	Salldimi i gypave të Çelikut DN 80 (llogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1
62	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 25/60 ose të ngjajshme	Copë	1

63	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 32/ 70 ose të ngjajshme	Copë	1
64	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 32/ 80 ose të ngjajshme	Copë	1
65	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 40/ 120 trefazore ose të ngjajshme	Copë	1
66	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 50-70 monofazore ose të ngjajshme	Copë	1
67	Furnizimi dhe montimi i pompë qarkulluese IMP GHN 50-120 trefazore ose të ngjajshme	Copë	1
68	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 65-120 trefazore ose të ngjajshme	Copë	1
69	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 80-120 trefazore ose të ngjajshme	Copë	1
70	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 100-120 trefazore ose të ngjajshme	Copë	1
71	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese Frekuentive NMT Max 40-80 ose të ngjajshme	Copë	1
72	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese Frekuentive NMT Max 50-80 ose të ngjajshme	Copë	1
73	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese Frekuentive NMT Max 65-80 ose të ngjajshme	Copë	1

74	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkuese Frekuentive NMT Max 80-80 ose të ngjajshme	Copë	1
75	Demontimi dhe montimi i pompave me qëllim servisimin e tyre	Copë	1
76	Furnizimi dhe montimi i ventillave të Radiatorit Ek.hyrës	Copë	1
77	Furnizimi dhe montimi i ventillave të Radiatorit Ek.dalës	Copë	1
78	Furnizimi dhe montimi i ventillave të Radiatorit të drejtë hyrës	Copë	1
79	Furnizimi dhe montimi i ventilave të Radiatorit të drejtë dalës	Copë	1
80	Furnizimi dhe montimi me termokoka	Copë	1
81	Furnizimi dhe montimi me Ventilla automatik të ajrosjes	Copë	1
82	Furnizimi dhe montimi F.M.Termomanometër 120 C	Copë	1
83	Furnizimi dhe montimi F.M.Termometër 120 C	Copë	1
84	Furnizimi dhe montim F.M.Manometër 10 bar	Copë	1
85	Servisimi i ventillatorit 0.37 kë 220 ose 380 volt, 2850 rpm	Copë	1
86	Servisimi i ventillatorit 0.75 kë 220 ose 380 volt, 2850 rpm	Copë	1
87	Servisimi i ventillatorit 1.1 kë 220 ose 380 volt, 2850 rpm	Copë	1
88	Servisimi i ventillatorit 1.5 kë 220 ose 380 volt, 2850 rpm	Copë	1
89	Servisimi i ventillatorit 2.2 kë 220 ose 380 volt, 2850 rpm	Copë	1

90	Servisimi i elektromotorit 1.1 kë 220 ose 380 volt, 2850 rpm	Copë	1
91	Servisimi i elektromotorit 1.5 kë 220 ose 380 volt, 2850 rpm	Copë	1
91	Servisimi i elektromotorit 2.2 kë 220 ose 380 volt, 2850 rpm	Copë	1
C	RADIATORËT, ENËT EKSPANDUESE DHE ELEMETET PËRCJELLËSE		
93	Furnizimi dhe montim-Ena e zgjerimit 50 litra	Copë	1
94	Furnizimi dhe montim-Ena e zgjerimit 100 litra	Copë	1
95	Furnizimi dhe montim-Ena e zgjerimit 150 litra	Copë	1
96	Furnizimi dhe montim-Ena e zgjerimit 200 litra	Copë	1
97	Furnizimi dhe montim-Ena e zgjerimit 300 litra	Copë	1
98	Furnizimi dhe montim-Ena e zgjerimit 400 litra	Copë	1
99	Furnizimi dhe montimi i Radiatorëve panel H-300 për metër gjatësi (tip22)	m'	1
100	Furnizimi dhe montimi i Radiatorëve panel H-600 për metër gjatësi (tip22)	m'	1
101	Furnizimi dhe montimi i Radiatorëve panel H-900 për metër gjatësi (tip22)	m'	1
102	Furnizimi dhe montimi i Radiatorëve panel Tip 33/H300 për metër gjatësi	m'	1
103	Furnizimi dhe montimi i Radiatorëve gypor 500/1400	Copë	1

104	Furnizimi dhe montimi i Radiatorëve gypor 500/1600	Copë	1
105	Furnizimi dhe montimi i Radiatorëve gypor 600/1400	Copë	1
106	Furnizimi dhe montimi i Radiatorëve gypor 600/1600	Copë	1
107	Furnizimi me Mbajtës të radiatorëve H 300	Copë	1
108	Furnizimi me Mbajtës të radiatorëve H 600	Copë	1
109	Furnizimi me Mbajtës të radiatorëve H 900	Copë	1
110	Demontimi dhe Montimi i radiatorit	Copë	1
111	Pastrimi i radiatorit	Copë	1
112	Furnizimi dhe montimi i kaloriferëve 10 kë me ujë	Copë	1
113	Furnizimi dhe montimi i kaloriferëve 15 kë me ujë	Copë	1
114	Furnizimi dhe montimi i kaloriferëve 20 kë me ujë	Copë	1
115	Riparimi i kaloriferëve me ujë	Copë	1
116	Ndrrimi i ventillave holander DN 15 (largimi i holanderëve të vjetër, furnizimi dhe montimi i të rinjëve)	Copë	1
117	Ndrrimi i ventillave holander DN 20 (largimi i holanderit të vjetër, furnizimi dhe montimi i të riut)	Copë	1

118	Ndrimi i ventillave holander DN 25 (largimi i holenderit të vjetër, furnizimi dhe montimi i të riut)	Copë	1
119	Ndrimi i ventilave holander DN 32 (largimi i holenderit të vjetër, furnizimi dhe montimi i të riut)	Copë	1
120	Furnizimi dhe montimi i vrimave të kolektorit 1">1x1/2" me lidhëse Cu	Copë	1
121	Furnizimi dhe montimi i vrimave të kolektorit 1">1x1/2" me lidhëse Al PVC	Copë	1
122	Furnizimi dhe montimi i flangjeve dhe kundër flangjeve DN 40	Copë	1
123	Furnizimi dhe montimi i flangjeve dhe kundër flangjeve DN 50	Copë	1
124	Furnizimi dhe montimi i flangjeve dhe kundër flangjeve DN 65	Copë	1
125	Furnizimi dhe montimi i flangjeve dhe kundër flangjeve DN 80	Copë	1
126	Furnizimi dhe montimi i flangjeve dhe kundër flangjeve DN 100	Copë	1
127	Furnizimi dhe montimi me valvola shiber DN 40	Copë	1
128	Furnizimi dhe montimi me valvola shiber DN 50	Copë	1
129	Furnizimi dhe montimi me valvola shiber DN 65	Copë	1
130	Furnizimi dhe montimi me valvola shiber DN 80	Copë	1
131	Furnizimi dhe montimi me valvola shiber DN 100	Copë	1
132	Furnizimi dhe montimi i ventillave sferik DN 15	Copë	1

133	Furnizimi dhe montimi i ventillave sferik DN 20	Copë	1
134	Furnizimi dhe montimi i ventillave sferik DN 25	Copë	1
135	Furnizimi dhe montimi i ventillave sferik DN 32	Copë	1
136	Furnizimi dhe montimi i Mledhësve të papastërtisë DN 32	Copë	1
137	Furnizimi dhe montimi i Mledhësve të papastërtisë DN 40	Copë	1
138	Furnizimi dhe montimi i Mledhësve të papastërtisë DN 50	Copë	1
139	Furnizimi dhe montimi i Mledhësve të papastërtisë DN 65	Copë	1
140	Furnizimi dhe montimi i Mledhësve të papastërtisë DN 80	Copë	1
141	Furnizimi dhe montimi i Mledhësve të papastërtisë DN 100	Copë	1
142	Furnizimi me mbajtës gypash të qelikut - dimensione të ndryshme	Copë	1
143	Furnizimi me mbajtës gypash Cu - dimensione të ndryshme	Copë	1
144	Furnizimi dhe montimi i valvulave mbushje-zbrazje 1/2"	Copë	1
145	Furnizimi dhe montimi i Valvulave siguruese 1/2" me presion 3 bar	Copë	1
146	Furnizimi dhe montimi i Valvulave siguruese 3/4" me presion 4 bar	Copë	1
147	Furnizimi dhe montimi i Valvulave siguruese 1" me presion 4 bar	Copë	1
148	Furnizimi dhe montimi i Valvulave siguruese 5/4" me presion 4 bar	m ²	1

149	Izolimi i gypave me llamarinë Al 0.55 mm dhe lesh mineral 50 mm	m ²	1
150	Izolimi i gypave me Armafleks t=13 mm	m	1
151	Furnizimi dhe ndërtimi i oxhakut fi (200 mm) me elemente të shamotit si dhe shtresa tjera të nevojshme deri në fasadimin dhe ngjyrosjen duke u përshtatur fasadës ekzistuese	m	1
152	Furnizimi dhe ndërtimi i oxhakut fi (250 mm) me elemente të shamotit si dhe shtresa tjera të nevojshme deri në fasadimin dhe ngjyrosjen, duke u përshtatur fasadës ekzistuese	m	1
153	Furnizimi dhe ndërtimi i oxhakut (fi 300 - 500 mm) me elemente të shamotit si dhe shtresa tjera të nevojshme deri në fasadimin dhe ngjyrosjen, duke u përshtatur me fasadës ekzistuese	m	1
154	Furnizimi me antifriz për ngrohjen qendrore në objektet e IEA	Litra	1
155	Furnizimi dhe lyerja me minium - antikorizon dhe ngjyrë	Copë	1
156	Furnizimi dhe montimi i ormanit elektrik për pompa dhe kallda komplet me siguresa dhe kontaktorë	Copë	1
157	Shqyrtimi ri programimi dhe lëshuarja në funksion e sistemeve	Copë	1
shuma e pëgjithshme meTVSH			

[Autoriteti Kontraktues bënë blerjen në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëratë përmendura në 1.1. .

1.4 Kontrata hynë në fuqi me **[30.05.2025]** dhe përfundon në datën **[29.05.2027]**

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 2 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë **Institucionet Edukativo Arsimore (IEA) dhe institucionet tjera komunale.**

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi. Vlera totale indikative e kontratës është **80.000.00 Euro**.(tedhjëtmijë euro)

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 ~~Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do ti nënshtrihen ndryshimeve për porosinë e vendosura nën këtë kontratë kornizë~~

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Furnizuesin

Emri:	Bekim Shabani	Emri:	Golri Haxhi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor.
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	28.05.2025	Data:	28.05.2025
Vula:		Vula:	



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Produktet"** përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 **"Autoriteti Kontraktues"** do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 **"Furnizues"** do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 **"Palë(t)"** do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 **"Inkotermet"** do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 **"Furnizim"** do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrë të përcaktuar në kontratë.

1.8 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 **"Shërbimet pas shitjes"** do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Furnizuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njuh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalojë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Siguria e ekzekutimit

8.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

8.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

8.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkohshme të pranimit.

Neni 9 Sigurimi

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë të siguruar plotësisht me një valute lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

9.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 9.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 10 Tatimi

10.1 Furnizuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

10.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

10.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të pranimit të mallrave.

10.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Furnizuesi.

Neni 11 Patentat dhe licencat

11.1 Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e fillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 12 Periudha e ekzekutimit të detyrave

12.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e lëshimit të Urdhër Blerjes, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 13.

Neni 13 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

13.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritret se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porositi furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhëra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

13.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

13.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 14 Vonesat e ekzekutimit

14.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrersë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.

14.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 14.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

- a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*
 - te konfiskoje garancinë e realizimit;

- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porposine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 15 Suspendimi

15.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

15.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

15.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

15.4 Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrimit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

15.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizuesi përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

15.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

15.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtësore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

15.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtësore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtësore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Cilësia e furnizimeve

16.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

16.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrë e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

16.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 17 Inspektimi dhe testimi

17.1 Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

17.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

17.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

17.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi

mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuara si duhet të rezultateve të testit të Autoritetit kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

17.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

17.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimin do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të furnizuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

17.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimin.

Neni 18 Parimet të përgjithshme të pagesave

18.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

18.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendrike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

18.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

18.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 18.2, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

18.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

18.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues është duke blerë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese, dhe nëse një autoritet kontraktues nuk plotëson obligimet e tij sipas kësaj kontrate sidomos obligimet e Nenit 18.2 furnizuesi mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQP mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i ndonjë dhe i të gjitha kontratave të përbashkëta kornizë të konkluduara nga AQP.

Neni 19 Dorëzimi

19.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

19.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes

së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

19.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

19.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimi derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimi të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

19.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 20 Operacionet e verifikimit

20.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

20.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimi, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjeshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

20.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbrësë nga paratë që do të paguhen ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

20.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimi, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 21 Pranimi i përkohshëm

21.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimi të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

21.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimi të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njëres nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimi të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke

thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose

- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

21.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimin ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

21.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimin të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimin të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimin përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

21.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

21.6 Pas pranimin të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimin siç kërkohen në kontratë.

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshhtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshhtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 23 Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24 Pranimi përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parrealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 25 Shkelja e kontratës

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytësore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përmbytësori brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;

- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbjllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rezhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë

specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose

b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, në shënime kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni, Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <i>SHQIPE</i>
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është shprehur nominalisht 8.000€, në kohezgjatje prej 25 muajsh.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i></p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <i>[2]</i> ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <i>30.05.2025/</i>
	17.2	Data e përfundimit i punimeve 29.05.2027, Kontrata mund të përfundojë edhe para kësaj date me shpenzimin e mjeteve të parapara për këtë projekt.
Regjistri i punës	20.1	Me fillimin e punëve do të hapet ditari i punës dhe do të mbahet deri sa të përfundojnë të gjitha punët sipas kontratës.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit caktohet: Samjl Shabani, ndërsa MDMK caktohet Rasim Hasani
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>nuk ka parapagim</i>
Mbajtja e Parasë	27.1	Pagesa do të kryhet sipas situacioneve të përfunduara dhe të pranuar nga

		menaxheri i kontratës i cili harton raport me shkrim për punët e përfunduara
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <u>[shëno numrin]</u> ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve, për të gjitha punët e kryera kontraktuesi do të garantojë për 12 muaj dhe cdo defekt që paraqitet gjatë kësaj kohe në punët që i ka kryer kontraktuesi do të përmersojë pa të drejtë pagese, ndërsa me rastin e pagesës së fundit kontraktuesi është i obliguar të dorëzojë sigurimin mbi kualitet në kohëzgjatje prej 12 muajve.
Penalizimi	15.3	Nëse kontraktuesi me fajin e tij nuk e kryen shërbimin në afatin e cekur ndaj tij do të aplikohen penalet në vlerë prej 0.25% të vlerës së përgjithshme të kontratës, për çdo ditë vonese. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Palët Kontraktuese pajtohen që kontestet eventuale që lindin me rastin e dispozitave të kësaj kontrate të zgjidhen me marrëveshje. Afati për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët kontraktuese pajtohen që të jetë 15 ditë nga dita e paraqitjes së kontestetit.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra për Ndermjetesim pranë Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <u>gjykata themelore e vendit në pajtim me ligjin në Kosovë</u> ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</i>

NR.	Përshkrimi i artikullit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi peshuar me TVSH	Çmimi peshuar me TVSH për secin produkt
A	Riparimi i KALLDAJAVE të ngrohjes					
1	Furnizimi dhe montimi me Flakës - Brener të Naftës për kalldat me lëndë djegëse të (Lëngët); kapacitet Q=150-300 kw, tip: Max-ECOFLAM ose e ngjajshme dhe me karakteristika të njejta.	Copë	1	650.00	1.9500 €	0.30%
2	Furnizimi dhe montimi me Flakës - Brener të Naftës për kalldat me lëndë djegëse të (Lëngët); kapacitet Q=300-500 kw; tip: Max-ECOFLAM ose e ngjajshme dhe me karakteristika të njejta.	Copë	1	1400.00	4.2000 €	0.30%
3	Furnizimi dhe montimi i spirales së transporterit të peletit me kapacitet të ndryshëm për brenera ECO- PB dhe të ngjajshëm	Copë	1	50.00	0.1500 €	0.30%
4	Furnizimi dhe montimi i gypit fleksibil të brenerave të peletit me kapacitet të ndryshëm për brenera ECO- PB dhe të ngjajshëm	Copë	1	100.00	0.0500 €	0.05%
5	Furnizimi dhe montimi i nxëmsit të brenerave të peletit me kapacitet të ndryshëm për brenera ECO- PB dhe të ngjajshëm	Copë	1	150.00	0.0150 €	0.01%
6	Furnizimi dhe montimi i vatrave të djegjes (reshetkave) për brenerat e peletit Q=50-90 kw; tip: ECO-PB ose e ngjajshme me karakteristika të njejta.	Copë	1	100.00	0.0200 €	0.02%
7	Furnizimi dhe montimi i vatrave të djegjes (reshetkave) për brenerat e peletit Q=100-250 kw; tip: ECO-PB ose e ngjajshme me karakteristika të njejta.	Copë	1	150.00	0.1500 €	0.10%
8	Furnizimi dhe montimi i vatrave të djegjes (reshetkave) për brenerat e peletit Q=300-500 kw; tip: ECO-PB ose e ngjajshme me karakteristika të njejta.	Copë	1	200.00	0.0400 €	0.02%



9	Furnizimi dhe montimi i motorrit të transporterit të peletit për breneret me kapacitet Q=50-100 kw; te modelit 5.3 rpm, 8.0 rpm dhe 12.0 rpm ose e ngjajshme me karakteristika të njejta.	Copë	1	70.00	3.5000 €	5%
10	Furnizimi dhe montimi i motorrit të transporterit të peletit për breneret me kapacitet Q = 100-400 kw; tip: GMAK -MKD 80 4 -37 50 Hz - 0.37 kW ose e ngjajshme me karakteristika të njejta.	Copë	1	100.00	5.0000 €	5%
11	Furnizim dhe montimi i pllakës elektronike për brenerat me pelet (50 - 400) kw	Copë	1	250.00	0.2250 €	0.09%
12	Furnizimi dhe montimi i pllakës elektronike për brenerat me pelet (100 - 400) kw	Copë	1	300.00	0.2700 €	0.09%
13	Furnizimi dhe montimi me display komandues për brenerat me pelet (50 - 100) kw	Copë	1	150.00	0.1350 €	0.09%
14	Furnizimi dhe montimi me display komandues për brenerat me pelet (100 - 400) kw	Copë	1	250.00	0.2250 €	0.09%
15	Pastrimi i rezervuarit të naftës komplet me korpen dhe elementet tjera përcjellëse	Copë	1	100.00	0.0900 €	0.09%
16	Mbrojtje termike nga mbingarkesat me resetim manuel dhe automatik nga nga 3,7 deri 5,5)A për motor 850W dhe 590W / 1PH	Copë	1	150.00	0.0300 €	0.02%
17	Kontaktor për pompa trefazore	Copë	1	150.00	0.0150 €	0.01%
18	Kontaktor për pompa monofazore	Copë	1	120.00	0.0120 €	0.01%
19	Furnizimi dhe montimi i Transportuesit kërrmillor të peletit për kalldajat 100 - 250 kw, komplet me elementet përcjellëse	Copë	1	400.00	0.2000 €	0.05%
20	Furnizimi dhe montimi i Transportuesit kërrmillor të peletit për kalldajat 300 kw; komplet me elementet përcjellëse	Copë	1	500.00	0.2500 €	0.05%



[Handwritten signature]

21	Furnizimi dhe montimi i rezervuarit të peletit me kapacitet 500 kg pelet. Në llogari hynë të gjitha elementet deri në funksionimin e plotë të rezervuarit.	Copë	1	50.00	1.6100 €	3.22%
22	Furnizimi dhe montimi i rezervuarit të peletit me kapacitet 1000 kg pelet. Në llogari hynë të gjitha elementet deri në funksionimin e plotë të rezervuarit.	Copë	1	100.00	0.0500 €	0.05%
23	Pastrimi komplet i oxhakut nga hiri dhe katrani nga fi 200 mm deri fi 500 mm për m/gjatësi	m	1	100.00	0.0100 €	0.01%
24	Furnizimi me Qynga dhe kthesa për kalldatë e llojeve të ndryshme	Copë	1	100.00	0.0200 €	0.02%
24	Shqyrtimi i instalimit në të ftohët dhe të nxehtë	Copë	1	400.00	0.0400 €	0.01%
B	SERVISIMET, RRJETI GYPOR DHE POMPAT				- €	
26	Servisimi i brenerit të peletit me kapacitete të ndryshme	Copë	1	300.00	0.1500 €	0.05%
27	Servisimi i kalldajave me lëndë djegese pelet; kapacitet (50 - 500) kw	Copë	1	100.00	0.0500 €	0.05%
28	Servisimi i kalldajave me lëndë djegese të ngurt (dru, thengjill); kapacitet (50 - 500) kw; sanimi i rrjedhjeve eventuale duke përfshirë salldimet e nevojshme	Copë	1	300.00	0.1500 €	0.05%
29	Servisimi i kalldajave me lëndë djegese të lëngët (naftë); kapacitet (100 - 300) kw	Copë	1	300.00	0.1500 €	0.05%
30	Servisimi i flakëhedhëseve me naftë; kapacitet (30-100) kw	Copë	1	150.00	0.0750 €	0.05%
31	Servisimi i flakëhedhëseve me naftë; kapacitet (100-300) kw	Copë	1	250.00	0.1250 €	0.05%
32	Servisimi i gjitha llojeve të pompave qarkulluese duke përfshirë ndrimin e pjesëve të dëmtuara si dhe mbështjellja elektrike	Copë	1	80.00	2.2400 €	2.80%
33	Servisimi i pompës qarkulluese DN 40 - 50, mbështjellja elektrike	Copë	1	20.00	0.5760 €	2.88%



[Handwritten signature]

34	Servisimi i pompës qarkulluese DN 65 - 80, mbështjellja elektrike	Copë	1	25.00	0.7250 €	2.90%
35	Servisimi i pompës qarkulluese DN 100 , mbështjellja elektrike	Copë	1	30.00	0.9000 €	3%
36	Furnizimi dhe montimi i gypave të zi metalik pa tegel (ky pozicion përfshinë largimin e gypit të dëmtuar, vendosjen e gypit të ri, salldimin eventual, zbrazjen dhe mbushjen e sistemit me lëng punues)				- €	
37	Gyp i zi DN 15	m'	1	2.00	0.0590 €	2.95%
38	Gyp i zi DN 20	m'	1	2.30	0.0656 €	2.85%
39	Gyp i zi DN 25	m'	1	3.10	0.0884 €	2.85%
40	Gyp i zi DN 32	m'	1	4.30	0.1226 €	2.85%
41	Gyp i zi DN 40	m'	1	5.16	0.1471 €	2.85%
42	Gyp i zi DN 50	m'	1	6.30	0.1796 €	2.85%
43	Gyp i zi DN 65	m'	1	7.70	0.2195 €	2.85%
44	Gyp i zi DN 80	m'	1	8.50	0.2423 €	2.85%
45	Furnizimi dhe montimi i elementeve si brryla , unaza etj nga poz. i gypave të zi (copë / metër)	Copë	1	80.00	0.0800 €	0.10%
46	Furnizimi dhe montimi i gypave Cu pa tegel (ky pozicion përfshinë largimin e gypit të dëmtuar dhe vendosjen e gypit të ri , salldimin eventual, zbrazjen dhe mbushjen e sistemit me lëng punues)				- €	
47	Gyp Cu Ø 15	m'	1	2.90	0.0827 €	2.85%
48	Gyp Cu Ø 18	m'	1	3.20	0.0912 €	2.85%
49	Gyp Cu Ø 22	m'	1	4.30	0.1226 €	2.85%
50	Gyp Cu Ø 28	m'	1	7.26	0.2069 €	2.85%
51	Gyp Cu Ø 35	m'	1	11.00	0.3135 €	2.85%
52	Furnizimi dhe montimi elementeve si berryla ,T, unaza etj nga poz. i gypave Cu (copë / metër)	Copë	1	80.00	0.0320 €	0.04%
53	Prerja e mureve dhe betonit për sanim të rrjedhjes ose për futjen e kalldasë në kalldatore	Copë	1	80.00	0.0320 €	0.04%
54	Salldimi i gypave të Çelikut DN 15 (llogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1	80.00	0.0320 €	0.04%
55	Salldimi i gypave të Çelikut DN 20 (llogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1	80.00	0.0320 €	0.04%



Handwritten signature

56	Salldimi i gypave të Çelikut DN 25 (Ilogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1	80.00	0.0320 €	0.04%
57	Salldimi i gypave të Çelikut DN 32 (Ilogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1	80.00	0.0320 €	0.04%
58	Salldimi i gypave të Çelikut DN 40 (Ilogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1	80.00	0.0320 €	0.04%
59	Salldimi i gypave të Çelikut DN 50 (Ilogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1	80.00	0.0320 €	0.04%
60	Salldimi i gypave të Çelikut DN 65 (Ilogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1	100.00	0.0400 €	0.04%
61	Salldimi i gypave të Çelikut DN 80 (Ilogaritet tegeli komplet apo sikur të salldohen dy gypa ndërmjet veti)	Copë	1	100.00	0.0400 €	0.04%
62	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 25/60 ose të ngjajshme	Copë	1	95.00	0.0380 €	0.04%
63	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 32/ 70 ose të ngjajshme	Copë	1	134.00	0.0536 €	0.04%
64	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 32/ 80 ose të ngjajshme	Copë	1	302.00	0.1208 €	0.04%
65	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 40/ 120 trefazore ose të ngjajshme	Copë	1	705.00	0.2820 €	0.04%
66	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 50-70 monofazore ose të ngjajshme	Copë	1	775.00	0.3100 €	0.04%
67	Furnizimi dhe montimi i pompë qarkulluese IMP GHN 50-120 trefazore ose të ngjajshme	Copë	1	780.00	0.3120 €	0.04%
68	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 65-120 trefazore ose të ngjajshme	Copë	1	950.00	0.3800 €	0.04%
69	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 80-120 trefazore ose të ngjajshme	Copë	1	1250.00	0.5000 €	0.04%



[Handwritten signature]

70	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese IMP GHN 100-120 trefazore ose të ngjajshme	Copë	1	1700.00	0.6800 €	0.04%
71	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese Frekuentive NMT Max 40-80 ose të ngjajshme	Copë	1	1050.00	0.4200 €	0.04%
72	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese Frekuentive NMT Max 50-80 ose të ngjajshme	Copë	1	1300.00	0.5200 €	0.04%
73	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkulluese Frekuentive NMT Max 65-80 ose të ngjajshme	Copë	1	1650.00	0.6600 €	0.04%
74	Furnizimi dhe montimi i Pompës qarkuese Frekuentive NMT Max 80-80 ose të ngjajshme	Copë	1	1700.00	0.6800 €	0.04%
75	Demontimi dhe montimi i pompave me qëllim servisimin e tyre	Copë	1	50.00	0.0500 €	0.10%
76	Furnizimi dhe montimi i ventillave të Radiatorit Ek.hyrës	Copë	1	80.00	0.0400 €	0.05%
77	Furnizimi dhe montimi i ventillave të Radiatorit Ek.dalës	Copë	1	80.00	0.0400 €	0.05%
78	Furnizimi dhe montimi i ventillave të Radiatorit të drejtë hyrës	Copë	1	80.00	0.0400 €	0.05%
79	Furnizimi dhe montimi i ventillave të Radiatorit të drejtë dalës	Copë	1	80.00	0.0400 €	0.05%
